



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.174, Datë 16.06.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN YLLI PJETËRNIKAJ”

Bazuar në nenet 149/a, *germa “e”*, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, *germa “a”* të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, si personel akademik me kohë të pjesshme, për lëndën “Procedurë Penale e Avancuar” në “Albanian University”, (Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative) Tiranë, për periudhën kohore që përfshin semestrin e dytë të vitit të parë, për vitin akademik 2022-2023.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Ylli Pjetërnikaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 16.06.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

